



Prishtinë, 19. 10. 2011  
Referenca: Nr. 01/2011

#### KOMISIONI SHQYRTUES

Komisioni shqyrtues në përbërje të:

1. Ylber Aliu, Kryesues
2. Avni Ramadani, Anëtar
3. Mejrem Cërnobregu, Anëtare

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE	
Nr. prot./Prot. Br./ Prot. No.	515
Njësi/Unitet/Unit	KSH
Nr. shprehjes/Exp. Br./Reg. No.	
Data/Date	19.10.2011
PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINA	

#### Në çështjen e ankesës së:

Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), Sh. A (më tutje: KMDK), adresa: Zija Shemsiu, 23, Prishtinë. KMDK është e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina (më tutje: ZRRUM), me numër të licencës: SL&L 544, për aktivitetin e autorizuar: Operim i deponive të mbeturinave, për periudhën kohore: 01. 10. 2007 – 30. 09. 2012 (Ankesa e datës: 08. 11. 2010, me Nr. 02/2010).

#### Kundër vendimit të:

ZRRUM-it Nr. 426 i datës: 26. 10. 2011 me të cilën gjohet KMDK në vlerë prej 5.000.00 (mijë) euro për shkak se, sipas ZRRUM-it, KMDK ka caktuar tarifa në mënyrë arbitrare dhe pa marrë pëlqimin paraprak të ZRRUM-it (Vendimi i ZRRUM-it i datës: 26. 10. 2010, me Nr. 426/2010).

#### BAZA JURIDIKE

1. Neni 34 i Ligjit për Ndryshimin e Rregullorës së UNMIK-ut 2004/49 mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave (më tutje: Ligji Nr. 03/L-086) dhe neni 10 i procedurës së Komisionit shqyrtues.

#### PËRMBLEDHJA E FAKTEVE

2. Përmes vendimit të datës: 26. 10. 2010, me Nr. 426 ZRRUM konstaton se: I. KMDK ka bërë shkelje të sanksionuar me nenin 32. 3, pika b, të Ligjit Nr. 03/L-086. II. KMDK nuk ka vepruar në pajtim me nenin 11 të Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit dhe Deponimit të Mbeturinave në Kosovë (më tutje: R-02/M&DM). III. KMDK nuk i është përmbajtur pikës 4. 3 të Licencës së Shërbimit. IV. KMDK për shkeljen e bërë gjobitet në vlerë prej 5.000.00 (pesëmijë) Euro. V. Obligohet KMDK të veprojë në pajtim me nenin 32. 4 të Ligjit Nr. 03/L-086.
3. Me datë: 08. 11. 2010, KMDK brenda afatit kohor ligjor prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, ashtu sikurse e parasheh neni 34. 1 i Ligjit Nr. 03/L-086, ka parashtruar ankesë në Komisionin shqyrtues kundër vendimit të ZRRUM-it.
4. Në ankesën e parashtruar Komisionit shqyrtues, KMDK pohon se në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L087, Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123, Ligjin për Mbeturina Nr. 02/L-30, Ligjit Nr. 03/L-086, është kompani publike e nivelit qendror, që ka nën operim DS-Mirash, DS-Landovicë, DS-Velekincë, DS-Dumnicë, dhe stacionin e transferit në Gërlicë, në të cilat operonë në bazë të licencës së lëshuar nga ZRRUM-i.
5. Në ankesë KMDK shton se tarifa për deponim të mbeturinave të ngurta komunale në deponitë të KMDK-së caktohet nga ZRRUM-i. Kësaj tarife i është përmbajtur gjithmonë. Më tutje, KMDK SH. A, thotë se, nuk ka bërë shkelje të nenit 32.3, pika b, të Ligjit Nr. 03/L-086, por ka vepruar konform Ligjit për Mbeturina Nr. 02/L-30, neni 5, pika 4, ku thuhet se ndotësi paguan dhe konform afarizmit të ndërmarrjes dhe gjendjes së rëndë financiare.
6. Në ankesën drejtuar Komisionit shqyrtues, KMDK, poashtu, pohon se, me paralajmërimin nga ana e ZRRUM-it të datës: 13. 09. 2010, Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim Nr. 010/09-10, që të shfuqizojë vendimin e KMDK-së Nr. 10/300 të datës: 10. 02. 2010 dhe prej datës 15. 09. 2010 nuk do të pranojë asnjë mbeturinë me afat të skaduar (mishrat dhe mbetjet shtazore, produktet me afat të skaduar) në Deponitë Sanitare të Menaxhuara nga KMDK.

#### PREZANTIMI I ARGUMENTEVE

7. Komisioni shqyrtues në takimin e punës të mbajtur me datë: 26. 09. 2011 ka vendosur të ofrojë mundësin përfaqësuesit të ZRRUM-it dhe KMDK-së në Komisionin shqyrtues të dëgjojë argumentet e tyre lidhur me vendimin dhe ankesën.
8. Në dëgjimin e mbajtur nga Komisioni shqyrtues me datë: 30. 09. 2011, përfaqësuesja e ZRRUM-it ka arsyetuar vendimin për gjobitje duke u bazuar në

faktin se, sipas ZRRUM-it, KMDK "I ka dhënë vetes autoritet me caktu tarifa për të cilat nuk është e autorizuar".

9. Ky pohim është kundërshtuar nga përfaqësuesi i KMDK-së, i cili në dëgjimin e mbajtur para Komisionit shqyrtues me datë: 04. 10. 2011, pohon se, "Tarifa për deponim të mbeturinave të ngurta komunale në deponitë e KMDK-së caktohet nga ZRRUM-i dhe kësaj tarife i është përmbajtur gjithmonë". Mirëpo, sipas përfaqësuesit të KMDK-së, "Qmimet janë caktuar për një kategori tjetër të mbeturinave (mishrat dhe mbetjet shtazore)", ndërsa ZRRUM-i ka autoritet me caktu tarifa vetëm për mbeturinat e ngurta komunale.
10. Në prezantimin e argumenteve të veta, KMDK pohon se ka vepruar konform Ligjit për Mbeturina Nr. 02/ L 30, neni 5, pika 4, ku thuhet se ndotësi paguan dhe pika b) Shpenzimet për krijimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, duhet të llogaritet çmimin e prodhimit dhe shërbimit, konformë afarizmit të ndërmarjes dhe gjendjes së rëndë financiare.
11. Përfaqësuesi i KMDK-së rikujtoj vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. 010/09-10 të datës: 15. 09. 2010 për shfuqizimin e vendimit të KMDK-së Nr. 10/300 të datës: 10. 02. 2010.
12. Përfaqësuesja e ZRRUM-it pranoj faktin se Bordi i Drejtorëve ka shfuqizuar vendimin e KMDK-së Nr. 10/300 të datës: 10. 02. 2010 pas paralajmërimit të ZRRUM-it, i cili veprim është marrë si masë lehtësuese për mos shqiptimin e ndonjë gjobe më të madhe nga ana e ZRRUM-it. Mirëpo "Dëftesat e parashtruar si dëshmi mjaftojnë të kuptojm se ka shkelje si të Licencës së Shërbimit dhe caktim të tarifave të shërbimit qoftë edhe vetëm një rast" konstatoj përfaqësuesja e ZRRUM-it.
13. Përfaqësuesi i KMDK-së potencoi se, fatura Nr. 0027123 dhe Nr. 51008 janë sipas tarifës të caktuar nga ZRRUM-i për mbeturinat e ngurta komunale, kurse fatura me Nr. 025231 është inkasuar sipas çmimit të caktuar nga KMDK për agjësime (vendimit të KMDK).

#### VLERËSIMI

14. Komisioni shqyrtues vlerëson se ankesa e KMDK-së është bërë brenda afatit kohor ligjor, mirëpo për shkak të mungesës së emërimit të Kryesuesit të Komisionit shqyrtues nga Kuvendi, është shtyrë shqyrtimi i kësaj ankese deri më tani.
15. Komisioni shqyrtues vlerëson se KMDK, me anë të vendimit Nr. 10/300 të datës: 10. 02. 2010, ku në mënyrë eksplicite pohohet se:  
*"Prej datës 1 nëntor të gjitha mbeturinat ushqimore me afat të skaduar, të cilat sillen në deponitë që i menaxhon KMDK-ja, do të paguajnë nga 60 Euro për tonelatë".*

16. Pra duke caktuar tarifa (apo çmime) për shërbime pa marr pëlqimin paraprak të ZRRUM-it, KMDK ka vepruar në kundërshtim me këto kërkesa (obligime) ligjore:
17. Neni 9. 1 i Ligjit Nr. 03/L-086 ku përcaktohet se:
- "Ofruesi i shërbimit cakton pagesën e konsumatorët e tij për shërbimet e veta në përputhje me tarifat për shërbime të caktuara ose miratuara nga Rregullatori" (lexo: ZRRUM-i).*
18. Mandej neni 10. 1 i Ligjit Nr. 03/L-086 ku përcaktohet se:
- "Secili ofrues i shërbimeve ose furnizues i ujit të papërpunuar duhet të bëjë kërkesë te Rregullatori në mënyrën e përcaktuar nga ai në pajtim me rregullat e nxjerra sipas nenit 38. 1 (a) për miratimin e çdo tarife ose ndryshimeve të ndonjë tarife të miratuar".*
19. Nenin 28. 1 të Rregullës R-02/M&DM ku përcaktohet se:
- "Rregullatori duhet të aprovojë me shkrim Aplikacionin për Tarifa të Shërbimeve me apo pa ndryshime, me anë të lëshimit të Urdhëresës për Tarifat e Shërbimit".*
20. Urdhëresën për Tarifë Shërbimi e nxjerr nga ZRRUM-i për KMDK-në, pika 3 Tarifa e Shërbimit, ku përcaktohet se:
- "Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë Sh. A, për shërbimet e deponimit të mbeturinave do të aplikojë tarifën në lartësi prej 5. 26 Euro / ton të mbeturinave të deponuara".*
21. Kjo Urdhëresë për Tarifë Shërbimi ka pasur vlefshmërin kohore prej: 01. 06. 2009 deri me: 31. 05. 2010. Pra gjatë periudhës kohore kur është miratuar vendimi i KMDK-së Nr 10/300.
22. Përfaqësuesi i KMDK-së nuk e ka kontestuar vendimin Nr. 10/300 të datës: 10. 02. 2010, por e ka arsyetuar këtë vendim duke u bazuar në atë se:
- "Tarifa për deponim të mbeturinave të ngurta komunale në deponitë e KMDK-së caktohet nga ZRRUM-i dhe kësaj tarife i është përmbajtur gjithmonë". Mirëpo "Qmimet janë caktuar për një kategori tjetër të mbeturinave (mishrat dhe mbetjet shtazore), ndërsa ZRRUM-i ka autoritet me caktu tarifa vetëm për mbeturinat e ngurta komunale".*
23. Sipas Komisionit shqyrtues, në rastin konkret KMDK nuk ka shfrytëzuar të drejtën që i jep neni 10. 4 i Ligjit Nr. 03/L-086 ku lejohet që ZRRUM-i dhe ofruesi i shërbimit:
- "Mund të lidhin marrëveshje me shkrim për të ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar rregullat që zbatohen për caktimin e tarifave duke përfshirë mënyrën se si dhe kur*

*mund të ndryshohen këto tarifa pas konsultimit me komisionin konsultativ të konsumatorëve".*

24. Përpos Ligjit, të drejtën për të kërkuar korigjimin e Tarifave të Shërbimit, në rastin e shfaqjes së rrethanave të cilat nuk kanë mundur të parashikohen gjatë dorëzimit të Aplikacionit për Tarifa të Shërbimeve, ofruesve të shërbimeve ja siguron edhe neni 30 i Rregullës R-02/M&DM.
25. Komisioni shqyrtues mirëpret vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. 010/09-10 të datës: 15. 09. 2010, të cekur si në ankesë ashtu edhe në prezantimin e përfaqësuesit të KMDK-së, për shfuqizimin e vendimit të KMDK-së Nr. 10/300 të datës: 10. 02. 2010. Gjithashtu, Komisioni shqyrtues në vlerësimin e ankesës ka parasysh gjendjen e rënd financiare të KMDK-së, që pengon funksionimin normal të kompanisë dhe sjelljen pozitive të KMDK-së gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës në Komisionin shqyrtues.

#### PËR KËTO ARSYE

1. Komisioni shqyrtues në pajtim me nenin 34. 4 Ligjit Nr. 03/L-086 dhe me nenin 10 të procedurës : me shumicë të votave:

#### VENDOS

1. Mbetet në fuqi vendimi ZRRUM-it Nr. 426 të datës: 26. 10. 2010.
2. Hedh poshtë ankesën e KMDK-së Nr. 02 të datës: 08. 11. 2010.
3. Obligohet KMDK të veprojë në pajtim me nenin 33. 3 (b) të Ligjit Nr. 03/L-086.
4. Obligohet KMDK të veprojë në pajtim me nenin 32. 4 të Ligjit Nr. 03/L-086.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e lëshimit.

**Këshillë juridike:** Në bazë të nenit 35 të Ligjit Nr. 03/L-086, palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashirojnë ankesë në Gjyqin Kompetent për shqyrtim gjyqësor brenda një (1) muaji nga data kur ofruesit të shërbimeve i është dorëzuar me shkrim vendimi përkatës nga Komisioni shqyrtues.

Kryesuesi i Komisionit shqyrtues:

Ylber Aliu

